



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

Nr. 613 Prot.

Tiranë më 15.08.2023

UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 613, datë 15.08.2023

PËR SHPENZIMET PROÇEDURIALE

Në mbështetje të neneve 148 pika 1 dhe 4, 148/dh shkronja "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 11 pika 2, 15 pika 2 shkronjat "a" dhe "e" të ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" (i ndryshuar), neneve 13 pika 1 shkronja "b" dhe pika 2 shkronja "b", 15, 42 shkronja "a", 46 pikat 1, 2, 4 fjalia e dytë, dhe 5, 47 e vijues të ligjit nr.97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), neneve 485-487 të Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar dhe ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

UDHËZOJ:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi të përgjithshëm është unifikimi i procedurave dhe tarifave për mënyrën e llogaritjes dhe dokumentimin e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti në fazën e hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe për marrjen e masave në zbatim të vendimeve gjyqësore për pagimin e detyrimeve të caktuara për shpenzimet procedurale.

Neni 2 Objekti

1. Objekt i këtij udhëzimi të përgjithshëm janë:

- a) Njehsimi i procedurave dhe i tarifave për mënyrën e llogaritjes dhe dokumentimin e shpenzimeve procedurale që parapagohen nga shteti, për veprimet procedurale të kryera sipas ligjit¹ nga prokurori, hetuesi i Byrosë Kombëtare të Hetimit ose oficeri nga shërbimet e policisë gjyqësore në fazën e hetimeve paraprake.
- b) Përcaktimi i shpenzimeve procedurale të tjera të dokumentuara rregullisht gjatë hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore.
- c) Përcaktimi i mënyrës së administrimit të dokumentacionit dhe shpërblimit/pagesës për secilin subjekt nga sektori financës dhe menaxhimit të aktiveve në prokurori.
- ç) Përcaktimi i masave dhe veprimeve procedurale që merren nga prokurori për:
 - kërkimin e sekuestros konservative në fazën e hetimeve paraprake,
 - kërkimin në diskutimet përfundimtare lidhur me disponimin e gjykatës për pagimin e shpenzimeve procedurale,
 - disponimin e prokurorit në urdhrin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor penal të formës së prerë për shpenzimet procedurale.

Neni 3 Përkufizime

Në këtë udhëzim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Prokuroria e Posaçme" është Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, me juridiksion të posaçëm².
2. "Shpenzime procedurale" janë shpenzimet e parapaguara nga shteti në të gjitha fazat e hetimeve paraprake penale dhe hetimeve pasurore, për të cilët me vendimin përfundimtar të gjykatës caktohet detyrimi për pagimin e shpenzimeve të parapaguara shtetit³.
3. "Shpenzime të dokumentuara rregullisht" janë, por pa u kufizuar vetëm në to, shpenzimet dhe pagesat sipas tarifave e kritereve të përcaktuara në akte nënligjore në fuqi, për veprime dhe/ose shërbime të ofruara për përkthime, ekspertime, mbrojtje të detyrueshme nga shteti, njoftime dhe mbulimin e shpenzimeve të dëshmitarëve/deklaruesve dhe/ose viktimave⁴.

¹ Shih, nenin 485 pikat 2 e 3 të Kodit të Procedurës Penale.

² Shih, nenin 4 pika 1 të ligjit nr.95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar" (i ndryshuar) dhe nenin 2 shkronja "ç" të ligjit nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar).

³ Shih, nenin 485 pika 2 të Kodit të Procedurës Penale.

⁴ Shih, - Vendimi nr.607 datë 29.07.2020 i Këshillit të Ministrave " Për tarifën për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"; -Udhëzimi nr.4 datë 12.12.2012 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor" (i ndryshuar); -Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë Nr.8, datë 19.7.2022 "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike"; -Udhëzimi i Përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.1134/1 datë 23.03.2006 dhe nr.1331/1 datë 16.03.2006 "Për miratimin e tarifave për veprimet dhe shërbimet që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore"; -Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme nr.35, datë 05.02.2016 "Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga policia e shtetit"; - Urdhri i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Kryetarit të

4. "Ndhimë juridike" është shërbimi juridik falas dhe shërbime të tjera të parashikuara në ligj, për personat që përmbushin kriteret ligjore, të cilëve u garantohet/paguhet nga shteti⁵.

5. "Përtjashtim nga tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore" është një formë e ndihmës juridike falas për përtjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore ose procedurale penale, me vendim të organit procedurës/gjykatës kompetente, në rastet kur plotësohen kriteret ligjore⁶.

Neni 4

Parime për shpenzimet procedurale

1. Shpenzimet procedurale parapagohen nga shteti, me përtjashtim të atyre të parashikuara me ligj.

2. Shpenzimet procedurale nuk mund t'i ngarkohen të pandehurit kur çështja pushohet me arsyetimin se del qartë se fakti nuk ekziston, fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, dhe i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale.

3. Shpenzimet procedurale për përsëritjen e akteve të deklaruara të pavlefshëm në fazën e hetimeve paraprake, kur faji është i organit procedues (oficerit nga shërbimet e policisë gjyqësore, prokurorit ose gjykatës), nuk mund t'i ngarkohen të pandehurit ose viktimës.

KREU II

SHPENZIMET E DOKUMENTUARA DHE TË VEÇANTA

SEKSIONI 1

SHPENZIMET E DOKUMENTUARA

Neni 5

Shpenzimet në hetimet paraprake penale dhe hetimet pasurore

Në fazën e hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore, prokurorët, hetuesit e B.K.H-së, hetuesit financiar dhe oficerët nga shërbimet e policisë gjyqësore, për çdo procedim penal dhe pasuror, administrojnë shpenzimet procedurale të dokumentuara rregullisht dhe llogarisin e administrojnë shpenzimet procedurale për veprime dhe/ose shërbime të veçanta të ofruara sipas llojeve, të cilët parapagohen nga shteti, sipas tarifave dhe kriterëve të përcaktuara në ligj, aktet nënligjore dhe në këtë udhëzim⁷.

Neni 6

Llojet e shpenzimeve

1. Shpenzimet për eksperimentet përfshijnë shpenzimet e dokumentuara që janë kryer për eksperimentet lidhur me verifikimin e mundësisë së të parit, dëgjimit ose kryerjes së disa

Dhomës Kombëtare të Avokatisë nr.1284/3, datë 16.3.2005 "Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike", F.Z nr.extra datë 27/12/2007.

⁵ Shih, nenin 8 e vijues të ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

⁶ Shih, nenet 25,26,27 e 28 të ligjit nr.111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti"

⁷ Shih, neni 485 paragrafët 1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale.

veprimeve të caktuara rast pas rasti, siç mund të jenë verifikimi i mekanizmit të kryerjes së veprës penale në vendin e ngjarjes apo përcaktimi i drejtimit të qitjes në vendin e ngjarjes për vepra penale të kryera me armë zjarri dhe veprime hetimore të tjera sipas metodikave të veçanta në kryerjen e eksperimentit⁸.

2. Shpenzimet për këqyrjet përfshijnë shpenzimet e dokumentuara që janë kryer për këqyrjet e vendeve, përfshirë vendin e ngjarjes, këqyrjet e personave, sendeve dhe kufomave⁹.

3. Shpenzimet për ekspertimet e dokumentuara përfshijnë:

a) Shpenzimet për ekspertimet kriminalistike që janë kryer, të llogaritur sipas llojit, mbështetur në tarifata e ekspertimeve kriminalistike të Institutit të Policisë Shkencore në fuqi¹⁰.

b) Shpenzimet për shërbimet mjeko-ligjore që janë kryer, të llogaritur sipas llojit, mbështetur në tarifata e shërbimeve mjeko-ligjore të Institutit të Mjekësisë Ligjore në fuqi¹¹.

c) Shpenzimet e ekspertimit të mbrojtjes kundër zjarrit (MKZ) që janë kryer, të llogaritur sipas llojit, mbështetur në tarifata e shërbimeve të Mbrojtjes Kundër Zjarrit në fuqi¹².

ç) Shpenzimet e çdo lloji ekspertimi tjetër më fusha të posaçme teknike, shkencore ose kulturore sipas tarifave të përcaktuara për kryerjen e tyre.

4. Shpenzimet për njoftimet përfshijnë shpenzimet e dokumentuara për njoftimin¹³ e deklaruesit, viktimës, ekspertit, përkthyesit, paditësit civil në procesin penal, të pandehurit, personit nën hetim (person fizik apo person juridik), si dhe mbrojtësit, në format dhe/ose nga organet përkatëse nëpërmjet:

a) Shërbimit postar;

b) Telefonit të bërë nga sekretaria e Prokurorisë së Posaçme ose nga policia gjyqësore e shoqëruar me aktin përkatës;

c) Letër rekomande me lajmërim marrje, brenda ose jashtë vendit;

ç) Shpalljes publike, brenda apo jashtë vendit ose afishimit në faqen elektronike të Qendrës Kombëtare të Biznesit për persona juridik;

d) Njoftimit nga policia gjyqësore në vendbanimin apo qëndrimin, ose në vendin e punës apo në selinë e personit juridik;

dh) Njoftimit nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme i personave të huaj që gëzojnë imunitet.

5. Shpenzimet për mbrojtjen e detyrueshme¹⁴ përfshijnë:

a) Shpenzimet për avokatët në rastet kur kërkohet mbrojtja e detyrueshme e paguar nga shteti, për shërbimet e kryera nga mbrojtësi i caktuar/zgjedhur sipas ligjit nga organi proçedues, në listën e vënë në dispozicion nga Dhoma e Avokatisë, sipas tarifave në fuqi të shërbimit për

⁸ Shih, nenet 176-177 të Kodit të Procedurës Penale.

⁹ Shih, nenet 198-201 të Kodit të Procedurës Penale.

¹⁰ Shih, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë të Financave dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme nr.35, datë 05.02.2016 "Për miratimin e tarifave për shërbimet e ofruara nga policia e shtetit", bashkëlidhur

¹¹ Shih, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë nr.1134/1 datë 23.03.2006 dhe nr.1331/1 datë 16.03.2006 "Për miratimin e tarifave për veprimet dhe shërbimet që ofron Instituti i Mjekësisë Ligjore", bashkëlidhur.

¹² Shih, Vendimin nr.607 datë 29.07.2020 të Këshillit të Ministrave "Për tarifata për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", bashkëlidhur.

¹³ Shih, nenet 132, 133, 134, 135, 137, 138, 140, 140/a, 142 paragrafi 1 e vijues të Kodit të Procedurës Penale

¹⁴ Shih, nenin 49 pika 1 shkronjat "b", "c", "ç", "dh", "e", "e", pika 2 e 3 dhe nenin 58 pika 1 shkronja "c" të Kodit të Procedurës Penale; -urdhrit e përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë nr.1284/3, datë 16.3.2005 "Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike", F.Z nr.extra date 27/12/2007; - nenin 49 pika 7 dhe nenin 49/a të Kodit të Procedurës Penale të lidhur nenet 18, 19 pikat 1 e 3, 20 pika 1 e 21 të ligjit nr.111/2015 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

shqyrtimin e shkresave/akteve procedurale dhe mbrojtjen e detyrueshme të të pandehurit apo personit nën hetim ose për ndihmën juridike falas të viktimës.

b) Shpenzimet për shërbimet e kryera nga avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të cilët sipas ligjit, ofrojnë ndihmë juridike detyruese në fazën e hetimeve, për kategoritë e veçanta ose për përfitues me të ardhura/pasuri të pamjaftueshme.

6. Shpenzimet për rastet e dhënies së ndihmës juridike falas¹⁵ përfshijnë shpenzimet për dhënien e ndihmës juridike falas që i afrohet kategorive të veçanta përfituesve me të ardhura/pasuri të pamjaftueshme përfshihen pagesat e shpenzimeve të dokumentuara rregullisht për dëshmitarët, ekspertët, psikologët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend, sipas përcaktimeve në ligj dhe aktet nënligjore.

Pagesat, në rastet kur gjykata ka vendosur përjashtimin nga pagesa e shpenzimeve procedurale në zbatim të ligjit, kryhen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, sipas rregullave dhe procedurës së përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrit të Drejtësisë¹⁶.

7. Shpenzimet për përkthyesit përfshijnë shpenzimet për përkthimin e akteve të ndryshme, sipas tarifave të miratuara me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, në fuqi¹⁷.

8. Shpenzimet për interpretët e gjuhës së shenjave përfshijnë shpenzimet për shërbimin e interpretimit të gjuhës së shenjave shqipe gjatë hetimit të një çështjeje penale, sipas tarifave të miratuara me udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, në fuqi¹⁸.

9. Shpenzimet procedurale në hetimet pasurore përfshijnë shpenzimet e sekuestrimit, të administrimit, të konfiskimit, të mbrojtjesit, si dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar sipas ligjit.

10. Shpenzimet të tjera përfshijnë shpenzimet për kancelaritë, për letër, lidhëse dosjesh, kapakë dosjesh apo shpenzime të tjera operative administrative që kryhen për nevoja të hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore.

SEKSIONI 2

SHPENZIMET DHE PAGESAT E EKSPERTËVE¹⁹

Neni 7

Kriteret e përcaktimit të shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve

1. Në fazën e hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore, prokurori ose oficeri nga shërbimet e policisë gjyqësore, thërret ekspertë në një procedim penal apo pasuror, mbështetur

¹⁵ Shih, ligjin nr.111/2015 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".

¹⁶ Shih, udhëzimin nr.6, datë 20.08.2019 të Ministrit të Drejtësisë "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së pagesave të shpenzimeve gjyqësore, për të cilat është vendosur përjashtimi në rastin e dhënies së ndihmës juridike".

¹⁷ Shih, udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë Nr.8, datë 19.7.2022 "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike".

¹⁸ Shih, udhëzimin sipas referencës 17.

¹⁹ Shih, udhëzimin nr.4, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor", të ndryshuar.

në të dhënat e Regjistrit Elektronik të Ekspertëve, që administrojnë dhe vë në dispozicion Ministria e Drejtësisë, sipas kritereve të përcaktuara me aktin normativ përkatës²⁰.

2. Kur për nevoja të procesit, eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre, prokurori, hetuesi i B.K.H-së, hetuesi financiar dhe oficeri nga shërbimet e policisë gjyqësore, thërret ekspertë jashtë "Regjistrit Elektronik të Ekspertëve".

3. Caktimi i shpenzimeve që u takojnë ekspertëve bëhet në bazë të kushteve të mëposhtme:

a) Kur eksperti banon në një largësi deri në 100 km nga prokuroria ose nga shërbimet e policisë gjyqësore ku është thirrur për të kryer ekspertizën, trajtimi financiar i tij përfshin vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

b) Kur eksperti banon në një largësi mbi 100 km nga Prokuroria e Posaçme, B.K.H ose shërbimet e policisë gjyqësore ku është thirrur për të kryer ekspertizën, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

i) Dietë ditore, jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur ekspertiza zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë;

ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;

iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin Nr. 146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.

4. Pagesa për punën e kryer për ekspertimin nga eksperti i licencuar nuk mund të tejkalojë shumën 40.000 (dyzet mijë) lekë.

5. Në rastet kur eksperti caktohet nga gjykata në cilësinë e organit procedues, shpenzimet procedurale parapaguhën nga gjykata përkatëse.

Neni 8

Kriteret për caktimin e tarifave orare tavan për ekspertime komplekse

1. Në rastet kur eksperti nevojitet nga fusha të veçanta ekspertize, për të cilat ligji nuk parashikon licencimin e tyre, në llogaritjen e shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve, zbatohen kriteret e përcaktuara në nenin 7 të këtij udhëzimi.

2. Në rastet e kryerjes së ekspertimeve komplekse, që lidhet me nivelin e rëndësisë, vështirësisë dhe pritshmërisë së ekspertimit në ecurinë e hetimeve, ushtrimit të ndjekjes penale dhe zgjidhjes ligjore të çështjes ose me kategori ekspertimesh të përzier (miks) apo me volumin e akteve/dokumenteve objekt verifikimi, shqyrtimi e vlerësimi nga ekspertët, për llogaritjen e pagesës të ekspertit/ëve ose caktimin e tarifave orare, krahas kritereve të përcaktuara në nenin 7 të këtij udhëzimi, vlerësohen tarifatat orare nëse ato janë të përcaktuara në aktet ligjore apo nënligjore në fuqi, numri i ekspertimeve të kryera në raste të ngjashme dhe kohëzgjatja e afatit të ekspertimit. Këto elemente prokurori i çështjes, i vlerëson në konsultim në aspektin metodik/teknik, dhe paraprakisht negocion me ekspertin/ët e ftuar përkatës për formalizimin e një marrëveshjeje, duke synuar uljen e tarifës orare, marrëveshjeje e cila në aspektin

²⁰ Shih, udhëzimin nr.10619 datë 19.10.2018 i Ministrisë së Drejtësisë "Për krijimin, administrimin dhe vënien në dispozicion për publikun të Regjistrit Elektronik për Ekspertët" i ndryshuar.

administrativ/financiar vlerësohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe mund të miratohet prej tij, pas konsultimit në aspektin financiar/buxhetor me kancelarin ose në mungesë të tij me nëpunësin zbatues të Prokurorisë së Posaçme.

3. Ekspertit që kryen ekspertime të veçanta dhe/ose komplekse nuk mund t'i caktohet për të ofruar ekspertizën e tij në më shumë se 30% të numrit të çështjeve për të cilat është kërkuar e njëjta lloj ekspertize brenda një viti kalendarik në Prokurorinë e Posaçme.

Neni 9

Dokumentacioni i kërkuar për shërbimin e ofruar nga eksperti, urdhëri për shpërblim dhe fatura shoqëruese e urdhrit

1. Eksperti i angazhuar për herë të parë është i detyruar që në prokurori të dorëzojë këto dokumente:

- a) Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë;
- b) Certifikatën e numrit fiskal;
- c) Kopjen e llogarisë bankare në emër të tij, sipas rastit person fizik ose person juridik;
- ç) Kopjen e letërnjoftimit;
- d) Kopjen e licensës apo dokumentacioni që vërteton njohuritë në fushën përkatëse.

2. Pas përfundimit të ekspertimit, me dorëzimin e aktit të ekspertimit në sekretarinë e Prokurorisë së Posaçme, prokurori i çështjes nxjerr urdhrin për shpërblimin e ekspertit të caktuar, urdhër i cili nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe miratohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

3. Fatura e ekspertit që të jetë e zbatueshme duhet të jetë faturë fiskale e lëshuar nga platforma digjitale e faturave ose pajisje fiskale të autorizuara, si dhe duhet të përmbajë të dhëna:

- a) numrin e faturës;
- b) datën e faturës;
- c) emrin e lëshuesit të faturës (emri i ekspertit/biznesit);
- ç) numrin e llogarisë bankare në emër të ekspertit/biznesit tij;
- d) numrin fiskal të biznesit;
- dh) emrin e Prokurorisë së Posaçme dhe seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes;

SEKSIONI 3

SHPENZIMET PËR DEKLARUESIT OSE VIKTIMAT

Neni 10

Kriteret e përcaktimit të shpenzimeve dhe pagesave për deklaruesit ose viktimat²¹

1. Personat që kanë dijeni për veprën penale (deklarues) ose personat që kanë në cilësinë e viktimës, të cilët thirren dhe pyeten në këto gjatë hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore, kanë të drejtë për mbulimin e shpenzimeve për deklarimet e dhëna.

2. Caktimi i shpenzimeve, që u takon deklaruesve, bëhet, si më poshtë vijon:

- a) Kur deklaruesi/viktima banon në një largësi deri në 100 km nga Prokuroria e Posaçme, B.K.H ose shërbimet e policisë gjyqësore ku është thirrur për të dhënë shpjegime në cilësinë e

²¹ Shih, udhëzimin nr.4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”, të ndryshuar

personit që kanë dijëni për veprën penale, mbulimi i shpenzimeve përfshin vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifatat përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr. vendimin nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.

b) Kur deklaruesi banon në një largësi mbi 100 km nga prokuroria ose shërbimet e policisë gjyqësore ku është thirrur për të deklaruar, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:

i) Dietë ditore, në masën jo më shumë se 2500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë;

ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3000 (tre mijë) lekë, për çdo natë;

iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.146, datë 26.2.1998 të Këshillit të Ministrave "Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve", të ndryshuar.

c) Kur deklaruesi largohet nga vendi i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë. Shpërblimi kërkohet nga deklaruesi me anë të paraqitjes së një dokumenti me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës.

3. Të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit apo të paraburgosurit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, nuk gëzojnë të drejtën e pagesës së shpenzimeve, për deklarimet e dhëna.

Neni 11

Dokumentacioni dhe urdhri për pagimin e shpenzimeve të deklaruesit/viktimës

1. Deklaruesi dhe/ose viktima brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e veprimit procedural për të cilin është urdhëruar thirrja e tij, paraqet pranë prokurorit të çështjes dokumentet tatimore për shërbimet e ofruara dhe, sipas rastit, dokumentacionin vërtetues, si vijon:

a) Fatura/bileta tatimore për shpenzimet e transportit;

b) Fatura tatimore për shpenzimet e fjetjes;

c) Dokumentacion ligjor me karakter vërtetues për vlerën e pagës të vendit të punës;

2. Mosparaqitja e dokumenteve tatimore nga e ana e deklaruesit/viktimës sipas përcaktimeve të legjislacionit për tatimet përbën shkak për moskryerjen e pagesës.

3. Pas dorëzimit të dokumentacionit sipas pikës 1 të këtij neni, prokurori i çështjes nxjerr urdhrin për pagimin e shpenzimeve të deklaruesit/viktimës, urdhër i cili nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe miratohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

SEKSIONI 4

DOKUMENTIMI I SHPENZIMEVE PËR MBROJTJEN E DETYRUESHME

Neni 12

Dokumentacioni për shpërblimin e mbrojtësit të caktuar për mbrojtjen e detyrueshme, urdhri për shpërblim dhe fatura shoqëruese e urdhrin

1. Avokati mbrojtës i caktuar për mbrojtjen e detyrueshme, që është i angazhuar për herë të parë është i detyruar që të dorëzojë në sekretarinë e Prokurorisë së Posaçme dokumentet ligjore:

a) Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë dhe të avokatisë;

- b) Certifikatën e numrit fiskal;
- c) Kopjen e llogarisë bankare në emër të biznesit;
- d) Kopjen e letërnjoftimit.

2. Pas përfundimit të seancës dhe/ose shqyrtimit të shkresave dhe akteve procedurale në prokurori ose në policinë gjyqësore, prokurori i çështjes vlerëson dhe nxjerr urdhër për shpërblimin e mbrojtësit për shërbimin e ofruar për mbrojtjen e detyrueshme të pandehurit ose personit nën hetim ose të viktimës, urdhër i cili nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe miratohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

3. Fatura tatimore shoqëruese e urdhrat që të jetë e rregullt/zbatueshme duhet të jetë faturë fiskale e lëshuar nga platforma digjitale e faturave ose pajisje fiskale të autorizuara si dhe duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) numrin e faturës;
- b) datën e faturës;
- c) emrin e lëshuesit të faturës (emri i zyrës/biznesit/avokatit);
- ç) numrin e llogarisë bankare në emër të avokatit/biznesit/zyrës së tij;
- d) numrin fiskal të avokatit/biznesit;
- dh) emrin e Prokurorisë së Posaçme dhe seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes.

SEKSIONI 5 SHPENZIMET PËR PËRKTHYESIT

Neni 13 Shpenzimet për përkthyesit²²

1. Për përkthyesit e jashtëm të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, pagesat bëhen në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave, në fuqi.
2. Në rastet kur përkthyesi do të thirret për t'u paraqitur në prokurori ose në policinë gjyqësore për të kryer shërbime përkthimi, krahas pagesës për përkthim, u mbulohen edhe shpenzimet ditore në të njëjtën masë, referuar në kriteret për shpenzimet dhe pagesat e ekspertëve dhe deklaruesve/viktimave të normuara në këtë udhëzim.
3. Në raste të veçanta dhe për nevoja të ngutshme, me autorizim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mund të realizohet pagesa sipas tarifave të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë në fuqi, edhe për përkthyesit, të cilët nuk janë përfshirë në listën e përkthyesve të jashtëm të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.
4. Kriteret për përzgjedhjen dhe komunikimin me përkthyesit zyrtar, bëhen sipas parashikimeve në VKM nr. 407 datë 05.07.2023 "Për përcaktimin e kriterëve e të rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe të mënyrës së kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë.
5. Pas vendim caktimit të përkthyesit zyrtar, si dhe me marrjen përsipër të shërbimit të përkthimit, përkthyesi zyrtar lidh kontratën për përkthimin zyrtar.²³

²² Shih, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë Nr.8, datë 19.7.2022 "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike"

Neni 14
Dokumentacioni për shpërblimin e përkthyesit, urdhri për shpërblim dhe fatura shoqëruese e urdhrit

1. Përkthyesi i angazhuar për herë të parë është i detyruar që të dorëzojë në prokurori këto dokumente:
 - a) Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë/përkthimit;
 - b) Certifikatën e numrit fiskal;
 - c) Kopjen e llogarisë bankare në emër të përkthyesit/biznesit;
 - ç) Kopjen e letërnjoftimit.
2. Pas përfundimit të seancës, apo përkthimit të shkresave/akteve procedurale, me dorëzimin e akteve/shkresave të përkthyer, prokurori i çështjes nxjerr urdhër për shpërblimin e përkthyesit të caktuar, urdhër i cili nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe miratohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
3. Fatura shoqëruese e urdhrit që të jetë e rregullt/zbatueshme duhet të jetë faturë fiskale e lëshuar nga platforma digjitale e faturave ose pajisje fiskale të autorizuar si dhe duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a) numrin e faturës;
 - b) datën e faturës;
 - c) emrin e lëshuesit të faturës (emri i zyrës/biznesit/përkthyesit);
 - ç) numrin e llogarisë bankare në emër të përkthyesit/biznesit/zyrës së tij;
 - d) numrin fiskal të përkthyesit/biznesit;
 - dh) emrin e Prokurorisë së Posaçme dhe seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes.

SEKSIONI 6
SHPENZIMET PËR INTERPRETËT E GJUHËS SË SHENJAVE

Neni 15
Shpenzimet për interpretët²⁴

1. Për interpretët e gjuhës së shenjave të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, pagesat bëhen në zbatim të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrit të Financave, në fuqi.
2. Në rastet kur interpreti do të thirret për t'u paraqitur në prokurori ose në policinë gjyqësore për të kryer shërbime përkthimi të gjuhës së shenjave, krahas pagesës për përkthim, u mbulohen edhe shpenzimet ditore në të njëjtën masë, referuar në kriteret për shpenzimet dhe pagesat e ekspertëve dhe deklaruesve/viktimave të normuara në këtë udhëzim.

²³ Shih VKM nr. 407 datë 05.07.2023 "Për përcaktimin e kriterëve e të rregullave për përzgjedhjen, kontraktimin dhe shpërblimin e përkthyesve zyrtarë, si dhe të mënyrës së kontrollit të shërbimit të kryer nga përkthyesit zyrtarë.

²⁴ Shih, udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë Nr.8, datë 19.7.2022 "Për përcaktimin e tarifave për kryerjen e shërbimit të përkthimit zyrtar dhe interpretimit të gjuhës së shenjave dhe rregullave për përjashtimin nga pagesa e tarifave për kategori të personave përfitues të ndihmës juridike"

3. Në raste të veçanta dhe për nevoja të ngutshme, me autorizim të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, mund të realizohet pagesa sipas tarifave të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë në fuqi, edhe për interpretë, të cilët nuk janë përfshirë në listën e përkthyesve të jashtëm të miratuar nga Ministri i Drejtësisë.

Neni 16

Dokumentacioni për shpërblimin e interpretit, urdhri për shpërblim dhe fatura shoqëruese e urdhrit

1. Interpreti i angazhuar për herë të parë është i detyruar që të dorëzojë në prokurori këto dokumente:
 - a) Certifikatën e regjistrimit të veprimtarisë/interpretit;
 - b) Certifikatën e numrit fiskal;
 - c) Kopjen e llogarisë bankare në emër të interpretit/biznesit;
 - ç) Kopjen e letërnjoftimit.
2. Pas përfundimit të seancës, apo përkthimit të gjuhës së shenjave, prokurori i çështjes nxjerr urdhër për shpërblimin e interpretit të caktuar, urdhër i cili nënshkruhet nga prokurori i çështjes dhe miratohet nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
3. Fatura shoqëruese e urdhrit që të jetë e rregullt/zbatueshme duhet të jetë faturë fiskale e lëshuar nga platforma digjitale e faturave ose pajisje fiskale të autorizuara si dhe duhet të përmbajë këto të dhëna:
 - a) numrin e faturës;
 - b) datën e faturës;
 - c) emrin e lëshuesit të faturës (emri i zyrës/biznesit/interpretit);
 - ç) numrin e llogarisë bankare në emër të interpretit/biznesit/zyrës së tij;
 - d) numrin fiskal të interpretit/biznesit;
 - dh) emrin e Prokurorisë së Posaçme dhe seksionit përkatës, shërbimin e ofruar dhe numrin e çështjes.

SEKSIONI 7 SHPENZIME TË TJERA

Neni 17 Shpenzimet të tjera

Shpenzimet të tjera që përfshijnë shpenzimet për kancelaritë, për letër, lidhëse dosjesh, kapakë dosjesh apo fotokopje që kryhen për nevoja të verifikimeve apo hetimeve që kanë lidhje me hetimet paraprake penale ose hetimet pasurore, përllogariten për aq sa është e mundur, sipas vlerës së inventarizuar për mallrat apo kostos së shërbimeve, të cilat përcaktohen nga Kancelari i Prokurorisë së Posaçme çdo fillim viti kalendarik.

KREU III
ADMINISTRIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCEDURA E
PAGESËS/SHPËRBLIMIT

Neni 18

Procedura për dorëzimin dhe administrimin e dokumentacionit për shpërblimet

1. Urdhrat e shpërblimit të plotësuar dhe të nënshkuara sipas parashikimeve në këtë udhëzim nga, eksperti, deklaruesi/viktima, avokati/mbrojtësi, përkthyesi apo interpreti, së bashku me faturat përkatëse dhe dokumentacionin tjetër të përshkruar në udhëzim dorëzohen në rrugë protokollare dhe administrohen për likuidim tek Sektori i Financës së Prokurorisë së Posaçme.
2. Dorëzimi i dokumentacionit për muajin paraardhës duhet të bëhet brenda 10 ditëve nga dalja e urdhër shpërblimit. Përrjashtimisht, në rrethana të veçanta kur nuk është e mundur përmbushja e këtyre afateve për dorëzimin e dokumentacionit sipas normimit në pikën 1 të këtij neni, pagesa mund të realizohet me kërkesë të arsyetuar, me dhënien e pëlqimit/miratimit nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar/Sektori i Financës, pas kontrollit dhe verifikimit të të dhënave, kërkon dhe plotëson me dokumentacionin e nevojshëm sipas këtij udhëzimi për të vijuar me likuidim pranë degës së thesarit brenda afateve ligjore. Në rast të mungesës së fondeve buxhetore, sektori i financës përgatit një informacion/tabelën përmbledhëse, për secilin subjekt, e cila nënshkruhet nga Nëpunësi Autorizues/Kancelarja si dhe përgjegjësi i Sektorit të Financës. Tabela përmbledhëse dhe dokumentacioni përcjellës dorëzohet tek thesari i shtetit. Dorëzimi i tabelës me dokumentacionin e nevojshëm për muajin paraardhës bëhet deri më datën 10 të muajit vijues.

Neni 19

Procedura e shpërblimit/pagesës për secilin subjekt

1. Sektori i Financës njofton secilin subjekt (ekspertin, deklaruesin/viktimën, avokatin/mbrojtësin e detyrueshëm, përkthyesin, interpretin) për tërheqjen nga secili të pagesës/shpërblimit.
 - a) Njoftimi bëhet brenda 5 (pesë) ditëve nga kryerja e pagesës, në rrugë postare, elektronike, si dhe me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
2. Pagesa/shpërblimi që i takon secilit subjekt bëhet nga fondi i caktuar në llogarinë përkatëse të Prokurorisë së Posaçme, në zbatim të urdhrit të prokurorit të çështjes të miratuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.
3. Në rastin kur limiti mujor është i pamjaftueshëm për likuidimin e plotë të shumës së shpërblimit për secilin ose ndonjërin subjekt, likuidimi shtyhet në muajin pasardhës, sipas radhës kronologjike të urdhrave të prokurorit të njoftuara dhe të plotësuar me dokumentacionin tatimor provues.
4. Në rast të mungesës së fondeve buxhetore për pagesën e të gjithë shpenzimeve të përlllogaritura, Sektori i Financës kontabilizon çdo detyrim të mbartur, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e këtyre detyrimeve, për periudhat e ardhshme buxhetore.

Neni 20

Proçesverbali për shpenzimeve proçedurale

1. Shpenzimet proçedurale, të kryera në fazën e hetimeve paraprake penale dhe/ose hetimeve pasurore, sipas zërave dhe llojeve të tyre, para përfundimit të hetimeve, përshkruhen në një akt përmbledhës "Proçesverbal për shpenzimet proçedurale" sipas modeleve lidhja nr.1, dhe lidhja nr.2, bashkëlidhur, në zbatim të ligjit²⁵ dhe të këtij udhëzimi.
2. Në fashikullin e secilës çështje të dërguar me kërkesë për në gjykatë²⁶, vendoset/administrohet origjinali i "Proçesverbalit për shpenzimet proçedurale " dhe aktet/dokumentet provuese.
3. Në fashikullin që mban prokurori, krahas akteve të tjera, vendoset dhe administrohet kopja e "Proçesverbalit për shpenzimet proçedurale" dhe bashkëlidhur urdhrat e pagesave, faturat ose dokumente të tjera provuese të shpenzimeve proçedurale, sipas listimit të zërave dhe llojeve në procesverbalin përkatës.
4. Hetuesit e BKH/oficerët nga shërbimet e policisë gjyqësore/hetuesit financiar/specialistët në sekretarinë administrative bëjnë inventarin e dosjes dhe materialeve kancelarike të përdorura në fashikullin penal dhe ja kalojnë në mënyrë protokollare Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar. Sektori i Financës përllëgarit kostot dhe dërgon pranë prokurorit të çështjes informacionin mbi shpenzimet proçedurale dhe faturat e paguara nga Sektori i Financës së bashku me dokumentacionin justifikues.
5. Një kopje e "Proçesverbalit për shpenzimet proçedurale" administrohet në Sektorin e Financës të Prokurorisë së Posaçme, ku ndodhen dhe urdhër pagesa, fatura ose dokumente të tjera provuese të shpenzimeve proçedurale, të dhëna të cilat sipas listimit të veprave penale, zërave dhe llojeve të shpenzimeve në procesverbalin përkatës, mbahen nga nëpunësi/specialist i financës në "Regjistrin e shpenzimeve proçeduriale".

KREU IV

DISPONIME TË TJERA TË PROKURORIT PËR SHPENZIMET PROÇEDURALE

Neni 21

Garantimi i pagimit të shpenzimeve proçedurale

1. Për të garantuar pagimin e shpenzimeve proçedurale, prokurori për secilin proçedim/çështje që ka në ndjekje vlerëson kushtet/kriteret ligjore²⁷ dhe i kërkon gjykatës vendosjen e sekuestros konservative në pasurinë e të pandehurit/personit nën hetim dhe/ose të paditurit civil në procesin penal, për të garantuar që në fazën e hetimeve paraprake penale pagimin e shpenzimeve proçedurale të parapaguara nga shteti.

²⁵ Shih, nenet 115/1, 116, 485/2 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

²⁶ Shih, nenin 331 në lidhje me nenet 328, 329/a, 400, 406/a e 406/dh të Kodit të Procedurës Penale.

²⁷ Shih, nenin 270 dhe nenin 271 të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me sekuestron konservative.

2. Shpenzimet për sekuestrimin në hetimet pasurore²⁸ parapagohen nga shteti dhe pagohen nga personi, ndaj pasurive të të cilit vendoset sekuestrimi i pasurisë.

Neni 22

Disponimi i prokurorit në pushimin e çështjeve që ndiqen mbi ankim

1. Në rastet kur vendoset pushimi i çështjes për shkak të tërheqjes së ankimit, prokurori i çështjes në pjesën arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit, shprehet se i ngarkohet ankuesit shuma e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti²⁹, përveç se kur në aktin e tërheqjes është parashikuar me marrëveshje që shpenzimet procedurale janë tërësisht ose pjesërisht në ngarkim të personit kundër të cilit është bërë ankimi.
2. Në përfundim të hetimeve, për kundravajtjet penale që ndiqen mbi ankim, kur prokurori vendos pushimin e çështjes për shkak sepse fakti nuk ekziston ose se i pandehuri nuk e ka kryer, prokurori i çështjes në pjesën arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit, shprehet se i ngarkohet ankuesit shuma e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti³⁰.

Neni 23

Kërkesa në shqyrtimin gjyqësor

1. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, prokurori në konkluzionet përfundimtare, krahas kërkesave për deklarimin e fajësisë së të pandehurit dhe për caktimin e llojit dhe masës së dënimit, apo kërkesave për konfiskimin e pasurive sipas ligjit³¹, i parashton gjykatës kërkesën edhe për detyrimin e të pandehurit/ve dhe/ose të paditurit civil/ankuesit, apo nga personi, ndaj pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi i pasurisë, për të paguar shumën e shpenzimeve procedurale të parapaguara nga shteti³².
2. Kundër vendimit të gjykatës që nuk pranon kërkesën për disponimin lidhur me shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti, prokurorit mund të bëjë ankim në gjykatën më të lartë, sipas rasteve të parashikuara në ligj³³.

²⁸ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar.

²⁹ Shih, nenin 286 të Kodit të Proçedurës Penale.

³⁰ Shih, nenin 398 të Kodit të Proçedurës Penale.

³¹ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar

³² Shih nenet 378,393 e 485 paragrafi 3 të Kodit të Proçedurës Penale.

³³ Shih nenet 408, 412, 415, 422, 425 e vijues të Kodit të Proçedurës Penale dhe ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar.

Neni 24

Ekzekutimi i vendimit penal të formës së prerë në lidhje me shpenzimet procedurale dhe ankimi

1. Kur vendimi gjyqësor penal merr formë të prerë vendimi, prokurori i çështjes apo i ngarkuar me ekzekutimin e vendimit penal, krahas disponimeve të tjera, në pjesën arsyetuese dhe në pjesën urdhëruese përcakton zyrën e përmbarimit shtetëror përkatës për ekzekutimin e detyrimit të vendosur nga gjykata për shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti³⁴.
2. Për ankesat lidhur me shpenzimet procedurale vendos gjykata që ka dhënë vendimin, e cila procedon sipas rregullave të caktuara në ligj³⁵.

Neni 25

Informimi për shpenzimet procedurale

1. Shpenzimet procedurale të parapaguara nga shteti raportohen periodikisht, për çdo procedim penal ose pasuror, në shumën/vlerën totale në rubrikën përkatëse të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjes, me fillimin e funksionimit të tij.
2. Sektori i Financës në prokurori përllogarit kostot e shpenzimeve procedurale penale sipas veprave penale e zërave përkatëse për procedimet penale të përfunduara, si dhe kostot e shpenzimeve procedurale në hetimet pasurore.
3. Vlera/shuma totale e shpenzimeve procedurale raportohet periodikisht për periudhat 3, 6, 9 mujore e vjetore, tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

KREU V

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE, ZBATIMI, HYRJA NË FUQI DHE PUBLIKIMI

Neni 26

Shkeljet dhe përgjegjësia disiplinore

Shkelja e dispozitave ligjore referuese në këtë udhëzim të përgjithshëm dhe/ose moszbatimi i normimeve të përcaktuara në këtë udhëzim, mund të përbëjnë, shkelje disiplinore sipas ligjit dhe/ose shkak për nisjen e procedurave disiplinore ndaj prokurorit, dhe nëpunësve të Prokurorisë së Posaçme, sipas ligjit³⁶.

³⁴ Shih, nenet 463 paragrafi 1 dhe 486 paragrafi 1 të Kodit të Proçedurës Penale.

³⁵ Shih, nenet 471 dhe 487 të Kodit të Proçedurës Penale.

³⁶ Shih nenin 148/dh të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 101 pika 1 shkronja "a" "b" dhe 102 pika 1 shkronjat "c" "ç", "d" "dh", "e", "g", "i", "j", "nj"; pika 2 shkronjat "a", "b", "c", "ç", "d", "dh" të ligjit nr.96/2016, i ndryshuar dhe neni 89 e vijues të ligjit nr.97/2016 , i ndryshuar.

Neni 27
Zbatimi dhe mbikëqyrja


1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm për zbatim nga prokurori, hetuesi i B.K.H-së, hetuesi financiar, oficeri nga shërbimet e policisë gjyqësore, kancelari, nëpunësit zbatues (sektori financës) pranë kësaj prokurorie³⁷.
2. Sektori i Financës ngarkohet të bëj përditësimin e akteve nënligjore në zbatim për këtë udhëzim.
3. Plotësimi dhe raportimi i të dhënave në "Regjistrin e shpenzimeve proceduriale" fillon nga data 15.10.2023.
4. Me mbikëqyrjen e zbatimit të këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohet Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Kancelari dhe nëpunësit zbatues (sektori i financës) pranë kësaj prokurorie.

Neni 28
Hyrja në fuqi dhe publikimi

Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen e internetit të Prokurorisë së Posaçme.

DREJTUESI I PROKURORISË SË POSAÇME

ALTIN DUMANI



³⁷ Shih nenin 46 pika 1 dhe nenin 6 pika 2 të ligjit nr.97/2016, i ndryshuar.

LIDHJA NR. 1

PROÇESVERBAL

(Mbi shpenzimet procedurale për proçedimin penal/ mosfillimin e proçedimit penal nr. _____, të vitit _____)

Në Tiranë sot në datë _____, unë _____, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme, pasi studiova aktet e procedimit penal/mosfillimit të proçedimit penal nr. _____ të vitit _____, të dërguar me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq/ kërkesë për miratimin e urdhrit penal/ kërkesë për miratimin e marrëveshjes/ pezulluar/ pushuar/ mosfilluar, në bazë të nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. _____, datë _____, "Për shpenzimet procedurale", mbaj këtë proçesverbal mbi dokumentimin e shpenzimeve procedurale për veprimet e kryera.

Shpenzimet procedurale të dokumentuara në lidhje me këtë proçedim penal/ mosfillim proçedimi penal, pasqyrohen si më poshtë vijon:

NR	AKTI	VLERA	SASIA	SHUMA
1.	Këqyrjet e vendeve			
2.	Ekspertime mjeko-ligjore kimik			
3.	Ekspertim toksikologjik			
4.	Ekspertime ekonomike			
5.	Ekspertime teknike thike			
6.	Ekspertime autoteknike			
7.	Ekspertime			
8.	Ekspertime daktiloskopike			
9.	Ekspertime balistike			

10.	Vlerësim provash materiale			
11.	Ekspertim psikologjik			
12.	Ekspertime kimik			
13.	Bashkëpunim Ndërkombëtar			
14.	Mbrojtës Kryesisht			
15.	Njoftime postare			
16.	Përkthime dhe Noteri			
17.	Kancelari: > Kapak dosje > Flete te bardha (fotokopje, printime) Njoftime			
18.	Shpenzime automjeti			
19.	Shpenzime te tjera			

Shuma e shpenzimeve proceduriale në lidhje me procedimin penal/ mosfillimin e procedimit penal nr. _____, të vitit _____ është _____ (_____) lekë.

PROKURORI

LIDHJA NR. 2

PROÇESVERBAL

(Mbi shpenzimet proceduriale për proçedimin pasuror/ mosfillimin të proçedimit pasuror nr. _____, të vitit _____)

Në Tiranë sot në datë _____, unë _____, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme, pasi studiova aktet e procedimit pasuror/mosfillimit të proçedimit pasuror nr. _____ të vitit _____, në bazë të nenit 485 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar, ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme nr. _____, datë _____, “Për shpenzimet proceduriale”, mbaj këtë proçesverbal mbi dokumentimin e shpenzimeve proceduriale për veprimet e kryera. Shpenzimet proceduriale të dokumentuara në lidhje me këtë proçedim pasuror/mosfillim proçedimi pasuror, pasqyrohen si më poshtë vijon:

NR	AKTI	VLERA	SASIA	SHUMA
1.	Këqyrjet e vendeve			
2.	Ekspertime mjeko-ligjore kimik			
3.	Ekspertim toksikologjik			
4.	Ekspertime ekonomike			
5.	Ekspertime teknike thike			
6.	Ekspertime autoteknike			
7.	Ekspertime			
8.	Ekspertime daktiloskopike			
9.	Ekspertime balistike			
10.	Vlerësim provash materiale			

11.	Ekspertim psikologjik			
12.	Ekspertime kimik			
13.	Bashkëpunim Ndërkombëtar			
14.	Mbrojtës Kryesisht			
15.	Njoftime postare			
16.	Përkthime dhe Noteri			
17.	Kancelari: > Kapak dosje > Flete te bardha (fotokopje, printime) Njoftime			
18.	Shpenzime automjeti			
19.	Shpenzime te tjera			

Shuma e shpenzimeve procedurale në lidhje me proçedimin pasuror/ mosfillimin e proçedimit pasuror nr. _____, të vitit _____ është _____ (_____) lekë.

PROKURORI
